



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**VENDIM**  
**Nr. 268 datë 29.05.2024**

**PËR**  
**CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE NDAJ GJYQTARES ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 140, pika 2, shkronja “b”, 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 146, pika 2, shkronja “b” dhe 157, të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 86, shkronja “e” dhe 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 104, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, shqyrtoi kërkesën për procedim disiplinor nr. 05/2024, që iu përket:

**KËRKUES:**

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë.**

**SUBJEKT I PROCEDIMIT:**

**Znj. {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.**

**OBJEKTI I KËRKESËS:**

**1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates **znj. {...}**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.**

**2. Propozimin për caktimin e masës disiplinore  
-“Shkarkim nga detyra”.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nenet 104, pika 3 dhe 111, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancën dëgjimore të datës 29.05.2024, sipas parashikimeve të neneve 142 e vijues të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe dëgjoji në pretendimet përfundimtare:

- **Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, përfaqësuar me Autorizim nga inspektorët znj. {...} dhe z. {...}**, të cilët përfundimisht kërkuar: Pranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates, znj. {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 104, pika 3 dhe 111, pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe caktimin ndaj saj të masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”.
- **Përfaqësuesen me prokurë të magjistrates, av. {...}**, e cila kërkoi:
  1. Pezullimin e procedimit disiplinor të nisur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë deri në përfundim të gjykimit në ngarkim të të përfaqësuarës prej saj me vendim gjyqësor të formës së prerë nga Gjykata e Lartë dhe mbajtjen e statusit “*e pezulluar*”, sipas vendimit nr. 346 dt.27.07.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
  2. Rrëzimin e kërkesës për caktimin e masës disiplinore “*shkarkim nga detyra*” të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

## V Ë R E N:

### I. Rrethanat:

1. Magjistratja {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan deri në datë 21.07.2022, kohë kur është dhënë vendimi nr. {...}, datë {...} i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar referuar nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. 385/18 prot., datë 05.04.2024 ka depozituar për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (referuar në vijim dhe si Këshilli), me datë 05.04.2024, kërkesën me objekt “Fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

3. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor, mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 138 të Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 104, pika 3, e ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

4. Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*” ndaj magjistrates znj. {...}, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nga nenet 104 pika 3 dhe 111 pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 96/2016 “*Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar.

5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në informacionin në mediat audio vizive ka verifikuar dhe administruar të dhëna nga sistemi i menaxhimit të çështjeve dhe konkretisht nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

6. Nga këto të dhëna ka rezultuar se me vendimin penal nr. 45, datë 04.07.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur: ... “

*“1. Deklarimin fajtor të të pandehurës {...} për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal dhe dënimit e saj me 3 vjet burgim.*

*Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës {...} i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 vjet burgim.*

*Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi për pjesën e mbetur të dënimit, duke e vënë në provë të pandehurën, për një periudhë kohe prej 2 vitesh me kusht që gjatë kësaj kohe, duke filluar nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit, e pandehura të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.*

*Në aplikim të nenit 35/1 të Kodit Penal të pandehurës {...} i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vitesh.”*

7. Me vendimin nr. {...}, datë {...}, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka vendosur: “*1. Lënien në fuqi të vendimit nr. {...}, datë {...} të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*”

8. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 346, datë 27.07.2022, ka vendosur: “*Pezullimin nga detyra të magjistrates znj. {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, caktuar me vendimin nr. 64, datë 21.07.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*”

9. Në zbatim të parimit të ligjshmërisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrim të funksioneve të tij ligjore ka analizuar të dhënat e paraqitura me qëllim identifikimin e elementeve juridike si dhe fakteve apo rrethanave, për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm i cili justifikon fillimin e hetimit disiplinor. Referuar të dhënave mbi faktet që rezultojnë nga vendimi penal nr. {...}, datë {...} të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vendimi penal nr. {...} datë {...} të Gjykatës së Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si dhe vendimit nr. 346,

datë 27.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është konkluduar së ekziston dyshimi i arsyeshëm se shkelja disiplinore ajo e kryerjes së një krimi, për të cilin gjyqtare {...} është dënuar me vendim të formës së prerë, mund të jetë kryer.

10. Bazuar në nenin 124 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, këto të dhëna janë vlerësuar të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë, ndaj magjistrates {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkeljen disiplinore të kryerjes së një krimi për të cilin është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

11. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka arsyetuar se faktet e rezultuara nga të dhënat e paraqitura, përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 104 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkak të dënimit të magjistrates me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç, të Kodit Penal.

12. Sa më sipër, me vendimin nr. 385/1, datë 07.02.2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur: “Fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistrate {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 104 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

13. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me hetimin disiplinor, në mbështetje të nenit 132 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe neneve 77 dhe 80 të Kodit të Procedurave Administrative (të ndryshuar) në kuadër të hetimit disiplinor, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është administruar në cilësinë e provës, dokumentacioni si më poshtë:

13.1. Prokuroria e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (SPAK), me shkresën nr. 2539/1 prot., datë 15.02.2024, protokolluar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 385/11 prot., datë 16.02.2024, ka vënë në dispozicion vendimin penal të formës së prerë nr. 45, datë 04.07.2023, të dënimit të magjistrates {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shkurtim të vendimit penal nr.02, datë 26.01.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe Urdhrat e prokurorit datë 05.07.2023 dhe 05.02.2024 me shkresat nr.U150 prot.,Q.Sh., datë 05.07.2023 dhe nr. U15 Prot./Q.SH, datë 05.02.2024 “Për ekzekutimin e vendimit penal nr.45, datë 04.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 02, datë 26.01.2024, të Gjykatës

së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë për të dënuarën {...}”.

Me shkresën nr. U150 prot./Q.Sh., datë 05.07.2023, urdhri i prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal nr. 45, datë 04.07.2023 i është dërguar Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Elbasan, dhe për dijeni Av. Antoneta Sevdari, përfaqësuese ligjore e shtetases {...}, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë.

Me shkresën nr. U15 Prot./Q.SH, datë 05.02.2024, urdhri i prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal nr. 45, datë 04.07.2023 i është dërguar Këshillit të Lartë Gjyqësor Tiranë, Departamentit të Administratës Publike Tiranë, të dënuarës {...}, Av. {...} dhe për dijeni Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë (GJ.K.K.O).

13.2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me shkresën nr. 531/1 prot., datë 16.02.2024, protokolluar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 385/12 prot., datë 19.02.2024, ka vënë në dispozicion vendimin penal të formës së prerë nr. 45, datë 04.07.2023, të dënimit të magjistrates {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

13.3. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, me shkresën Nr. 206/1 Prot., datë 12.02.2024, protokolluar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 385/9 prot., datë 13.02.2024, ka vënë në dispozicion shkurtrimin e vendimit penal nr. 02, datë 26.01.2024, me të pandehur: {...}; {...}; {...}; {...}, e para e akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

13.4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, me shkresën Nr. 206/2 Prot., datë 29.03.2024, protokolluar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 385/14 prot., datë 29.03.2024, ka vënë në dispozicion vendimin e arsyetuar penal nr. 02, datë 26.01.2024, me të pandehur: {...}; {...}; {...}; {...}; e para e akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.”

13.5. Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr.917/2 Prot., datë 15.02.2024 regjistruar pranë ILD-së me nr. 385/10 prot., datë 15.02.2024, ka përcjellë informacion: “Në përgjigje tuajës nr. 385/5 prot., datë 07.02.2024, protokolluar me tonën nr. 917/1 prot., datë 09.02.2024, me anë të së cilës kërkoni informacion mbi statusin aktual të Znj. {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Elbasan, bazuar në dokumentacionin e dosjes personale të magjistrates (gjyqtare) që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ju bëjmë me dije se:- Lidhur me statusin aktual të magjistrates (gjyqtare) Znj. {...}, rezulton se me vendimin nr. 346, datë 27.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është deklaruar pezullimi nga detyra e magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të masës së sigurimit personal “ Arrest në

*shhtëpi”, caktuar me vendimin nr. 64, datë 21.07.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar.”*

## **II. Procedura:**

14. Menjëherë pas depozitimit të kërkesës së ILD për fillimin e procedimit disiplinor, me vendimin nr.182, datë 09.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vendosur hedhja e shortit dhe caktimi i anëtarit të Komisionit Disiplinor, z.Illir Rusi, në cilësinë e relatorit të çështjes. Vendimi për caktimin me short të relatorit të çështjes i është njoftuar palëve të procedimit disiplinor përkatësisht ILD-së dhe magjistrates znj. {...}, brenda afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 141 të Ligjit “*Për Statusin*”.

15. Me vendimin nr.201, datë 17.04.2024, mbi propozimin e relatorit, Këshilli vendosi kalimin e çështjes në seancë dëgjimore dhe caktimin e datës 02.05.2024, ora 11.00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

16. Në caktimin e seancës dëgjimore për magjistraten {...} , Këshilli ka vlerësuar, njëkohësisht dhe rastet e parashikuara nga neni 139 i Ligjit “*Për Statusin*”<sup>1</sup>, të cilat e çojnë atë drejt vendimmarrjes për mbylljen e procedimit disiplinor, pa zhvilluar seancë dëgjimore.

16.1. Në lidhje me rastin nëse shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, në nenin 117 të Ligjit “*Për Statusin*” përcaktohet se ato parashkruhen brenda pesë vjetëve. Nëse ILD merr të dhëna, sipas nenit 124 të ligjit<sup>2</sup>, pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk fillon hetimin për shkak të parashkrimit. Në çdo rast afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer. Pavarësisht këtyre parashikimeve, për shkeljet disiplinore që përbëjnë njëkohësisht vepra penale, afatet e parashkrimit përlllogariten sipas përcaktimeve të Kodit Penal, vetëm nëse në këtë Kod

---

<sup>1</sup>Neni 139 i ligjit nr.96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar - **Mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore** – “1. Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashikimeve të nenit 117 të këtij ligji; b) çështja ka qenë objekt i procedimit disiplinor që është zgjidhur me vendim të formës së prerë; c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”; ç) raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar. 2. Dorëheqja e magjistratit nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor. 3. Këshilli mbyll procedimin disiplinor, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim. Ai njofton palët për shkaqet e mbylljes.”

<sup>2</sup>Neni 124 i ligjit nr.96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar - **Fillimi i hetimeve me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë** - 1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh”. 2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos me vendim të arsyetuar për fillimin e hetimit me iniciativën e tij, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme. 3. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, zbatohen edhe në rastin e fillimit të hetimit me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.”

parashikohen afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet. Sipas të dhënave në dosjen hetimore dhe në raportin e hetimit, rezulton se gjyqtarja është dënuar me vendim penal nr. 45, datë 04.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin penal nr. 02, datë 26.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i cili ka marrë formë të prerë dhe është ekzekutuar me urdhrin datë 05.02.2024 nga S.P.A.K, ndërsa veprimet e konsideruara shkelje sipas fakteve të pranuar nga gjykata i përkasin vitit 2022, brenda afatit 5 vjeçar të parashkrimit të shkeljes disiplinore dhe si pasojë çështja nuk rezulton të jetë parashkruar. Ndërkohë theksohet se pavarësisht këtij parashikimi, për shkeljen disiplinore, e cila përbën dhe vepër penale, afatet e parashkrimit përlllogariten sipas dispozitave të Kodit Penal, nëse në këtë Kod parashikohen afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet. Referuar të dhënave në aktet e administruara, rezulton se shkelja disiplinore e pretenduar përbën njëkohësisht dhe vepër penale, sipas nenit 319/ç të Kodit Penal, nen i cili parashikon dënimin me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Duke patur në konsideratë datën e fillimit të hetimit disiplinor dhe afatin e parashkrimit për shkeljen disiplinore të pretenduar, i cili është 10 vjet, referuar parashikimeve të nenit 66/1 të Kodit Penal, hetimi disiplinor është brenda afatit të parashkrimit.

16.2. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera dhe të dhënat e dosjes hetimore, nuk rezultoi që shkeljet e pretenduara të kryera nga ana e magjistrates, të ketë qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor, të zgjidhur me vendim të formës së prerë.

16.3. Sipas nenit 134, pika 1, shkronja “ç” dhe “d” të Ligjit “Për Statusin”, parashikohet se Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin disiplinor, nëse provohet se rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se magjistrati i mbaron statusin, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64 të Ligjit “Për Statusin”<sup>3</sup> ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të ligjit<sup>4</sup> ose magjistrati ka vdekur. Nga verifikimet e kryera dhe nga të dhënat e dosjes hetimore, Këshilli ka arritur në përfundimin se për magjistraten {...} nuk rezultoi e provuar ekzistenca e ndonjë prej këtyre shkaqeve ligjore.

16.4. Bashkë me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, në Këshill është depozituar edhe raporti i hetimit të miratuar nga Inspektori, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 3 e Ligjit “Për Statusin”<sup>5</sup>. Referuar këtij parashikimi ligjor, Këshilli ka vlerësuar se raporti i

<sup>3</sup>Neni 64 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – **“Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit - 1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohet kushtet e pa zgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; c) mbush moshën 67 vjeç; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën....”**

<sup>4</sup>Neni 67 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – **“Pamundësia fizike dhe mendore e një magjistrati - 1. Me marrjen dijani, Këshilli heton rastet për pamundësi fizike dhe mendore të magjistratit, të cilat çojnë në largimin nga funksioni ose pezullimin e përkohshëm të magjistratit... .”**

<sup>5</sup>Neni 133 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – **“Dokumentacioni i hetimit - ... 3. Me përfundimin e hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën: a) emrin dhe mbiemrin e inspektorit kompetent; b) shkaqet për të filluar hetimin, subjektin dhe objektin**

hetimit është depozituar i arsyetuar në të gjithë elementët formalë të kërkuar nga kjo dispozitë.

17. Me anë të postës elektronike (email) në datë 17.04.2024, magjistratja u njoftua "*për fillimin e procedurës disiplinore*", duke iu bërë të ditura të drejtat e saj referuar nenit 141, pika 2 e Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenit 32 pika 1 të të Rregullores "Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor", e miratuar me vendimin 316, datë 14.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

18. Bashkë me njoftimin për caktimin e seancës dëgjimore, magjistrates iu njoftuan dhe të drejtat e saj gjatë procedimit disiplinor, si dhe iu caktua një afat deri në datë 30.04.2024 për të paraqitur një parashtrësë me shkrim, sipas përcaktimeve të nenit 141, pika 2, gërma a) të ligjit.

19. Në rrugë elektronike, në datë 17.04.2024, magjistratja konfirmoi marrjen dijene të njoftimit elektronik lidhur me fillimin e procedurës disiplinore, vendimin nr. 201, datë 02.05.2024, për caktimin e seancës dëgjimore në datë 02.05.2024, ora 11:00 si dhe mbi afatin e caktuar për të paraqitur parashtrësat me shkrim.

20. Gjithashtu me anë të shkresave nr. 2186/2 prot., datë 18.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "*njoftim i relatorit për fillimin e procedurës disiplinore*" dhe nr. 2186/3 prot., datë 18.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "*njoftim mbi fillimin e procedurës disiplinore*" magjistratja u njoftua për caktimin e datës 02.05.2024, ora 11.00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

20.1. Bashkëlidhur korrespondencës së mësipërme, magjistrates iu komunikua njoftimi i relatorit për fillimin e procedurës disiplinore (*i cili iu bë me dije edhe në formë elektronike në datë 17.04.2024*) si dhe vendimi nr. 201, datë 17.04.2024 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

21. Gjithashtu, me shkresën nr.2186/4 prot., datë 19.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "*njoftim vendimi*" magjistratja u njoftua për caktimin e datës 02.05.2024, ora 11.00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion

---

e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit; c) veprimet e kryera gjatë hetimit; ç) përmbledhjen e deklaratave të magjistratit përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve; d) parashtrimin e fakteve të pranuar dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre; dh) analizën ligjore të fakteve të pranuar që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur; e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore."



gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe bashkëlidhur iu komunikua vendimi nr. 201, datë 17.04.2024 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

22. Për shkresën nr. 2186/4 prot., datë 19.04.2024, magjistratja {...} mori dijëni rregullisht në datë 24.04.2024, duke konfirmuar fletën “*lajmërim marrje*” të shërbimit postar.

23. Me anë të postës elektronike, në datë 01.05.2024, protokolluar në Këshill me nr. 2186/5prot., datë 02.05.2024, magjistratja {...} duke konfirmuar marrjen dijëni të zhvillimit të seancës dëgjimore në datë 02.05.2024 ora 11:00, parashtroi se për arsye shëndetësore nuk mund të paraqitet dhe për këtë shkak kërkon shtyrjen e seancës për një datë tjetër.

24. Bashkëlidhur emailit, magjistratja paraqiti “Raport për paaftësi në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi”

25. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 02.05.2024, Këshilli pasi mori në shqyrtim kërkesën për shtyrje të magjistrates {...}, kërkoj mendimin e përfaqësueses së ILD, e cila kërkoj shtyrjen e seancës dëgjimore, vendosi shtyrjen e saj për në datë 16.05.2024 ora 11:00.

26. Me anë të postës elektronike në datë 02.05.2024 dhe me shkresën nr.2186/6 prot., datë 03.05.2024, magjistratja u njoftua mbi shtyrjen e seancës dëgjimore për në datë 16.05.2024 ora 11:00. Lidhur me këto njoftime rezulton se magjistratja ka marrë dijëni rregullisht duke konfirmuar dhe nënshkruar “*lajmërim marrjen*”.

27. Me aktin nr. 385/22 prot., datë 30.04.2024, protokolluar në Këshill me nr. 917/5 prot., datë 02.05.2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë depozitoi "Parashtresë e ILD lidhur me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan".

28. Me emailin e datës 15.05.2024, protokolluar në Këshill me nr. 2186/7 prot., datë 15.05.2024 me lëndë “Paraqitje prokurë përfaqësimi dhe caktim përfaqësuesi ligjor” magjistratja {...} vuri në dispozicion dokumentin “Prokurë e Posaçme” me nr.350 rep., dhe nr.250 kol., datë 15.05.2024, me anë të së cilës emëron si përfaqësuese të posaçme av. {...}, avokate pranë Dhomës së Avokatisë Elbasan, me nr. {...} license.

29. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 16.05.2024, përfaqësuesja me prokurë të posaçme av. {...}, kërkoj kohë të njëhej me aktet e dosjes hetimore të ardhura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

30. Këshilli, pasi mori mendimin e përfaqësueses së ILD, e cila u shpreh dakord me kërkesën e av. {...} për kopje të akteve të dosjes hetimore, vendosi pranimin e kësaj kërkesë dhe shtyrjen e seancës dëgjimore për në datë 29.05.2024, ora 10:00.

31. Me shkresën nr.917/6 prot., datë 17.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, avokates {...} iu dërgua kopje e dosjes hetimore të ardhur nga ILD me shkresën nr. 385/18 prot., datë 05.04.2024, me lëndë “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj magistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”. Rezulton se avokatja mori dijeni rregullisht duke nënshkruar “Lajmërim marrje” në datë 20.05.2024.

32. Me shkresën nr. 2186/9 prot., datë 17.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Njoftim për shtyrje seance dëgjimore” magistratja {...} dhe av. {...}, u njoftuan se për arsye të kërkesës së avokates {...} për të patur kohë për të marrë kopje të akteve të dosjes hetimore dhe për t’u njohur me to, si dhe për paraqitjen nga avokatja të Licensës dhe NIPT-it pranë institucioneve përkatëse, Këshilli shtyu zhvillimin e seancës dëgjimore për në datë 29.05.2024, ora 10:00. Lidhur me këtë njoftim rezulton se magistratja {...} dhe av. {...} morën dijeni rregullisht duke nënshkruar “Lajmërim marrjen” përkatësisht në datë 18.05.2024 dhe datë 20.05.2024.

33. Gjithashtu, me anë të postës elektronike në datë 17.05.2024, me lëndë “Mbi shtyrjen e seancës dëgjimore” magistratja {...} dhe av. {...}, u njoftuan se për arsye të kërkesës së avokates {...} për të patur kohë për të marrë kopje të akteve të dosjes hetimore dhe për t’u njohur me to, si dhe për paraqitjen nga avokatja të Licensës dhe NIPT-it pranë institucioneve përkatëse, Këshilli shtyu zhvillimin e seancës dëgjimore për në datë 29.05.2024, ora 10:00. Lidhur me këtë njoftim elektronik rezulton se magistratja {...} dhe av. {...} morën dijeni rregullisht duke konfirmuar në datë 17.05.2024.

### **III. Parashtrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:**

34. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka parashtruar dhe argumentuar pretendimet e tij në raportin e hetimit të depozituar në Këshill, të paraqitur së bashku me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor. Ato janë parashtruar dhe në vijimësi gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore të datës 16.05.2024 dhe 29.05.2024.

35. Në analizë të dokumentacionit të administruar në kuadër të procedimit disiplinor, rezultoi e provuar se nga ana e magistrates {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është kryer shkelja disiplinore e parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja "b" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 104 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, pasi konstatohet se magistratja {...} është dënuar më vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

36. Në rastin konkret, rezulton se plotësohen kushtet e parashikuara për t’u konsideruar si shkelje disiplinore, pasi magistratja subjekt hetimi disiplinor me dashje ka kryer veprën penale të "Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë" parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

37. Në funksion të procedimit disiplinor, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, është konstatuar se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin penal nr. 45, datë 04.07.2023, ka vendosur:

*“1. Deklarimin fajtor të të pandehurës {...} për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal dhe dënimin e saj me 3 vjet burgim.*

*Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës {...} i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 vjet burgim.*

*Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi për pjesën e mbetur të dënimit, duke e vënë në provë të pandehurën, për një periudhë kohe prej 2 vitesh me kusht që gjatë kësaj kohe, duke filluar nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit, e pandehura të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.*

*Në aplikim të nenit 35/1 të Kodit Penal të pandehurës {...} i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vitesh.”*

37.1. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. {...}, datë {...}, ka vendosur: *“ 1. Lënien në fuqi të vendimit nr. {...}, datë {...} të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”*

38. Në zbatim të vendimit të mësipërm, Prokuroria pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (SPAK) ka nxjerrë: Urdhrat e prokurorit datë 05.07.2023 dhe 05.02.2024 me shkresat nr.U150 prot.,Q.Sh., datë 05.07.2023 dhe nr. U15 Prot./Q.SH, datë 05.02.2024 *“Për ekzekutimin e vendimit penal nr. {...}, datë {...} të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 02, datë 26.01.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë për të dënuarën {...}”*

39. Në analizë të fakteve dhe pas vlerësimit të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit disiplinor, nga përmbajtja e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.45, datë 04.07.2023, rezulton se gjyqtare {...} është gjetur fajtorë për veprime, të cilat për nga natyra e tyre janë të shkallës më të rëndë sikundërse janë aktet korruptive të lidhura me ushtrimin e funksionit të gjyqtarës. Nga ana e gjykatës<sup>6</sup> është pranuar ekzistenca e këtyre fakteve dhe rrethanave në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal si më poshtë:

*“... Gjykata e Posaçme e Apelit sikurse konkludon dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë krijojnë bindjen tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura ka kërkuar një përfitim të parregullt monetar ndërsa ushtronte detyrën e gjyqtarës në çështjen gjyqësore lidhur me të pandehurin Xh. M. - Vëzhgimet dhe përgjimet e bisedave- konfirmojnë skemën korruptive të ndjekur nga i pandehuri T.R., në bashkëpunim me shtetasin I.P., avokat mbrojtës, për uljen e dënimit të shtetasit Xh.M. Kështu, i tillë akt i paligjshëm u programua nga të pandehurit*

<sup>6</sup> Në vendimin nr.02, datë 26.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në paragrafët 4 dhe 5, të këtij vendimi.

të realizohej nëpërmjet të pandehurit I.P., duke i propozuar ky i fundit të pandehurës {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan shumë e dakortësuar paraprakisht nga dy të pandehurit, prej 200.000 Lekë me qëllim për të zbutur masën e dënimit për të pandehurin Xh.M. I pandehuri T.R., do të dorëzonte shumë monedha tek avokati I.P., dhe ky i fundit tek gjyqtarja {...}. Nuk është realizuar dhënia përfundimtare e parave për shkak se, e pandehura në këmbim të favorizimit (uljes) së masës së dënimit kërkoi një shumë më të madhe monedha.

Gjykata e Posaçme të Apelit evidenton se provat dhe indiciet e këtij gjykimi të analizuar si më sipër, dëshmojnë në mënyrë të pakundërshtueshme jo vetëm dijeninë e të pandehurës për bisedat e realizuara nga avokati, por dhe kërkimin e transferuar tek palët të afërmit e shtetasit Xh.M., nëpërmjet avokatit I. P., për shumë e datave të kërkuara, në këmbim të ofrimit të uljes së masës së dënimit ndaj shtetasit Xh.M.

Vepër penale do të quhet e konsumuar edhe pa u realizuar konkretisht një shkëmbim parash shpërblim në përfitime të tjera mes dy palëve, pasi mjafton që të arrihet një marrëveshje *jactum sceleris* në formë premtimi për përfitime të parregullta të dyanshme, edhe pa marrjen e kontaktit të drejtpërdrejtë mes palëve, mjafton që funksionari të ketë dijeni rreth saj dhe marrëveshja korruptive mund të bazohet edhe nga fakte përmbyllëse.”

40. Në këndvështrim të nenit 104 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, rezulton e provuar se shkelja disiplinore e kryer nga gjyqtare {...} është realizuar “...tejt çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura ka kërkuar një përfitim të parregullt monetar ndërsa ushtronte detyrën e gjyqtarës në çështjen gjyqësore lidhur me të pandehurin Xh.M.”<sup>7</sup>, me qëllim që të ndikohet në kryerjen e detyrës funksionale të saj si gjyqtare, duke konsumuar elementët e figurës së veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, e parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

41. Referuar fakteve dhe rrethanave të pranuar nga gjykata, veprimet e gjyqtarës kanë cënuar veprimtarinë e rregullt të organeve të drejtësisë nga veprimet e parregullta të personave të jashtëm por edhe nga veprimet e vetë asaj si funksionare e drejtësisë. Veprimi i gjyqtarës {...} ka cënuar rëndë veprimtarinë e rregullt të organeve të drejtësisë për të siguruar integritetin jo vetëm të gjyqtarëve, por të të gjithë sistemit në tërësi, për të siguruar autoritetin, pavarësinë, paanësinë e organeve të drejtësisë në funksion të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të individëve.

42. **Lidhur me kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, referuar parashikimeve të nenit 115, pika 1, të ligjit nr. 96/2016** “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet se:

43. Në analizë të kriterit “**lloji dhe rrethanat e shkeljes**” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor rezulton se pas një vlerësimi të hollësishëm të çdo prove veçmas

<sup>7</sup> Faqe 74 e vendimit nr. {...}, datë {...} të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

dhe të gjitha provave së bashku, konstatohet se në rastin konkret, nga ana e magjistrates subjekt hetimi disiplinor janë ndërmarrë veprime, të cilat janë vlerësuar se përmbajnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe me qëllim përfitim të padrejtë prej saj, duke favorizuar një palë ndërgjyqëse nëpërmjet dhënies së vendimit. Dënimi i magjistratit për kryerjen e një vepre penale parashikohet si shkelje disiplinore nga neni 104 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

44. Në analizë të kriterit “*shkalla e fajësisë dhe motivi*”, referuar fakteve dhe rrethanave të pranuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykata e Posaçme e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në vendimet e tyre respektivisht me nr. {...}, datë {...}, dhe nr. {...}, datë {...}, rezulton se: “...vepra penale është kryer me motiv kryesor kërkimin të përfitimit të parregullt monetar<sup>8</sup> përkundërt kryerjes së një veprimi, për të zbutur masën e dënimit shtetasin Xh.M., nga gjyqtare {...}”.

45. Nga ana tjetër, neni 140 pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës parashikon konceptin e **shkeljes shumë të rëndë** për shkarkimin e gjyqtarit nga detyra kur: *b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi*”, përcaktim i cili gjen zbatim edhe në nenin 104, pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar sipas të cilit: “3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për atë që është e nevojshme”, dhe në nenin 111, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 96/2016 sipas të cilit “*shkarkimi i magjistratit nga detyra jepet si masë disiplinore vetëm në këto raste ...b)...* për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi.”

46. Për shkak të natyrës së shkeljes të përcaktuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga ILD nuk është vlerësuar e nevojshme marrja në analizë e kriterëve të tjera të përcaktuara në nenin 115 të ligjit nr. 96/2016 për përcaktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, rëndësi e cila përcaktohet qartësisht nga vetë ligji themeltar i shtetit si dhe nenet 104, pika 3 dhe 111 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**47. Nga përmbajtja e vendimit nr. {...}, datë {...} të Gjykatës së Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar rezulton se për caktimin e masës disiplinore të shkarkimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: a) gjyqtari të jetë dënuar për kryerjen e një krimi; b) vendimi i dënimit të jetë i formës së prerë.**

---

<sup>8</sup> Fq.75 e vendimit nr. 02, datë 26.01.2024, e GJPAKKO.

47.1 Vepra penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” për të cilën është gjetur fajtor dhe është dënuar gjyqtare {...} parashikohet si krim nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe përkufizohet “Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimit të një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e funksionit të tij, dënohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet”.

47.2. Neni 1/2 i Kodit Penal parashikon: “Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi”, ndërsa në nenin 32 të Kodit Penal parashikohen masat e dënimit me burgim sipas natyrës së veprës penale “Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet. Për kundërvajtje penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet”.

Referuar dispozitave të Kodit Penal të cituara më lart, qartësisht provohet se gjyqtare {...} është dënuar për kryerjen e një krimi atë të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, duke u plotësuar kushti i parë për llojin e masës disiplinore “**shkarkim nga detyra**”.

47.3. Përsa i përket kushtit të dytë të kërkuar nga dispozita, atë të marrjes së vendimit të dënimit formë të prerë, nga aktet e administruara rezulton se vendimi nr. {...}, datë {...} i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vendimi penal nr. {...}, datë {...} i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Krimin e Organizuar, i cili ka lënë në fuqi vendimin e sipërcituar, janë vendime gjyqësore të cilat janë dhënë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale të kryera me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, ligj i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.08.2017.

47.3.1. Neni 462 i Kodit të Procedurës Penale, me ndryshimet e ligjit nr. 35/2017, është formuluar: 1. *Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë...3 ) Janë vendime të formës së prerë ...b) vendimi i gjykatës së apelit kur zgjidh përfundimisht çështjen, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 428, të këtij Kodi;*

47.3.2. Neni 428 pika 1, e Kodit Penal parashikon: “Gjykata e Apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos: a. lënien në fuqi të vendimit; b. ndryshimin e vendimit; c. prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit”.

47.3.3. Rezulton se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë nr. {...}, datë {...}, me të cilin është dënuar gjyqtare {...}, për kryerjen e krimin të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, konsiderohet vendim i formës së prerë referuar parashikimeve të nenit 462, pika 3, shkronja b), të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 428, pika 1, shkronjat a) dhe b) të Kodit të Procedurës Penale.

Ky vendim i formës së prerë, me Urdhrat e prokurorit datë 05.07.2023 dhe 05.02.2024 me shkresat nr.U150 prot.,Q.Sh., datë 05.07.2023 dhe nr. U15 Prot./Q.SH, datë 05.02.2024

*“Për ekzekutimin e vendimit penal nr.45, datë 04.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 02, datë 26.01.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë për të dënuarën {...}”, të cilat i janë dërguar Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Elbasan, dhe për dijëni Av. Antoneta Sevdari përfaqësuese ligjore e shtetases {...}, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, Këshillit të Lartë Gjyqësor Tiranë, Departamentit të Administratës Publike Tiranë, të dënuarës {...}, Av. Antoneta Sevdari dhe për dijëni Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë (GJ.K.K.O).*

Për sa më sipër plotësohet edhe kushti i dytë i parashikuar në nenin 140, pika 2 shkronja b) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe neni 104, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, për caktimin e masës disiplinore të “shkarkimit nga detyra” parashikuar në Kushtetutë si dhe në nenin 111 pika 1 shkronja b), të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

48. Ndërsa në analizë të kriterit "**pasojë e shkeljes**" rezulton se ushtrimi i parregullt i detyrës nga ana e magjistrates, si dhe për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar, ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, ka diskredituar rëndë figurën, autoritetin, dinjitetin si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe organet e drejtësisë ka diskredituar rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, si dhe ka cënuar besimin e publikut te drejtësia. Besimi i publikut nuk është nocion i pa përkufizuar, por ai gjen mbështetje tek vlerat themelore, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratëve, sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në nenin 3, pika 5, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien e sigurimin e drejtësisë në shoqëri ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për institucionin e gjykatës janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike. Për rrjedhojë vlerësohet se shkelja disiplinore për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi që lidhet me ushtrimin e detyrës është e natyrës së tillë që e bën të padenjë të vazhdojë detyrën e gjyqtarës.

49. Në analizë të çështjes **mbi llojin e masës disiplinore**, është vlerësuar se qëllimi thelbësor i masës disiplinore është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklarimit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit për shkak të shkeljes disiplinore që ai ka kryer dhe marrja e masave aktive për edukimin e magjistratit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Në të njëjtën kohë masa disiplinore që caktohet ndaj magjistratit përmbush edhe dy qëllime parandaluese: (i) parandalimin e posaçëm, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe (ii) parandalimin e përgjithshëm, në kuptimin që

magjistratët e tjerë kuptojnë që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

50. Ndërkohë, në rastin kur shkelja disiplinore e kryer është aq e rëndë sa e bën magjistratin të papërshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar funksionin e tij, atëherë masa disiplinore nuk mund të luajë më rol edukues. Në këtë rast, masa disiplinore merr përsipër të mbrojë interesin publik, duke larguar nga detyra magjistratin dhe duke u kthyer kështu në masë me natyrë të pastër ndëshkuese ndaj tij. Kjo masë disiplinore përcaktohet pikësisht në nenin 140, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit gjyqtari shkarkohet nga detyra kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

50.1. Në të njëjtën kohë kjo masë parashikohet edhe në nenin 111 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku parashikohet përgjegjësia disiplinore e magjistratit për një shkelje shumë të rëndë, që e bën atë të papërshtatshëm ose të padenjë për të vazhduar ushtrimin e funksionit. Papërshtatshmëria ose padenjësia e magjistratit për të vazhduar funksionin mund të ketë si shkak: (i) dënimin e magjistratit për kryerjen e një krimi; (ii) paaftësinë e rëndë dhe dukshme të magjistratit; ose (iii) sjellje të kryer me pakujdesi të rëndë, që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor.

51. Kushtetuta ka parashikuar në disa norma detyrimin e magjistratëve për të respektuar me përpikmëri Kushtetutën, ligjet dhe për të ruajtur paanësinë e figurën e pastër në funksion të dhënies së një drejtësie bindëse. Nëse konstatohen raste të inkriminimit të magjistratëve, akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e magjistratit ose pamjaftueshmëri profesionale, organet përgjegjëse duhet të mbajnë qëndrimet e duhura deri në shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

52. Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara, duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore, ajo e kryerjes së një krimi për të cilin është dënuar me vendim të formës së prerë, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja b) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 104 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; faktin që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën “**Shkelje shumë të rëndë disiplinore**”, provohet se magjistrate {...} ka diskretitur pozitën dhe figurën e magjistratit, ka cenuar rëndë imazhin e drejtësisë dhe ka ulur besimin e publikut tek dhënia e drejtësisë.

53. Duke mbajtur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore së magjistratit, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e parashikuar nga ligji dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit; duke u bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore; individualizimit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj



magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, vlerësohet për shkeljen disiplinore të kryer nga magjistrate {...} duhet të jepet masa disiplinore **"Shkarkim nga detyra"**, parashikuar nga neni 140, pika 2 shkronja "b" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 104 pika 3 dhe 111 pika 1 shkronja "b", e ligjit nr. 96/2016 *"Për Statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar".

54. Për sa më sipër, kërkojmë nga Këshilli I Lartë Gjyqësor të admisnistrojë provat e paraqitura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja "dh", nenit 111, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar të vendosë:

*"Caktimin ndaj magjistrates {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja "b" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 104, pika 3, e ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të masës disiplinore "Shkarkim nga detyra".*

#### **IV. Parashtrimet e magjistrates:**

44. Magjistratja {...} gjatë zhvillimit të seancës datë 29.05.2024, nëpërmjet përfaqësueses me prokurë av. {...} ka paraqiti parashtrimet e saj në lidhje me procedurën disiplinore e cila po zhvillohet në Këshill, në të cilat parashtrohet:

44.1. Fillimisht përpara se tju prezantoj rrethanat për shkak të të cilave e përfaqësuar prej meje aktualisht rezulton të jetë me statusin e "gjyqtares së pezulluar nga ushtrimi i detyrës" dhe arsyet përse kundërshtojmë procedurën e fillimit të hetimit disiplinor, ju kërkoj:

1-*"Pezullimin e procedimit disiplinor të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, sipas vendimit nr.385/1 dt.07.02.2024 "për fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistrates {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, **deri në përfundim të gjykimit të çështjes penale në Gjykatën e Lartë**, bazuar ky kërkim në ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", sipas bazës ligjore të kërimit.*

2-*Lënien ne fuqi të vendimit nr.346 dt.27.07.2022 të K.L.GJ në lidhje me "pezullimin nga ushtrimi i detyrës së magjistrates" deri në përfundim të Gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe të marrjes së vendimit penal formë të prerë në kuptimin material.*

45. E përfaqësuar prej meje, magjistratja {...} rezulton punonjëse e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga viti 1984, teksa nga viti 1993 e në vazhdim ka ushtruar detyrën e gjyqtares, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

46. Me vendimin nr. 346 datë 27.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 151/1 gërma a) dhe nenin 155 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", është vendosur: "*pezullimi nga detyra i magjistrates {...} me detyrë Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan*".

47. Pezullimi nga detyra e gjyqtares sipas këtij vendimi është bërë, për shkak të çështjes penale të filluar nga SPAK, sipas procedimit penal nr. 209 /2021 dhe të caktimit të masës së sigurimit "arrest në shtëpi".

48. Çështja e sipërme penale është gjykuar në dy shkallë gjykimi dhe konkretisht :

48.1. Me vendimin nr.45 dt.04.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, ndaj të përfaqësuarës prej meje është dhënë një vendim fajësie. Dua të citoj faktin se ky vendim fajësie është marrë me shumicë votash, (pasi relatorja e çështjes ka dalë me vendim pafajësie në pakicë në favorin e të përfaqësuarës prej meje).

48.2. Vendimi, nr. {...} dt. {...} i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ankimuar nga e përfaqësuar prej meje në Gjykatën e Posaçme të Apelit dhe kjo e fundit në përfundim të gjykimit ka dalë me vendimin Nr. {...}, datë {...} me të cilin ka vendosur : "***Lënie në fuqi të Vendimit Nr. {...}, datë {...} të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*** Këtë vendim e përfaqësuar prej meje {...} e ka marrë të arsyetuar nga kjo gjykatë në dt.30.03.2024 dhe ka ushtruar te drejtën e recursit në Gjykatën e Lartë brenda afatit ligjor.Në momentin e marrjes së këtij vendimi, është njohur vetëm me një vendim fotokopje të dërguar nga k/sekretaria e asaj gjykate me shënimet përkatëse përbri emrit të çdo gjyqtari me siglën "d.v."Deri në këtë moment kuptohej që ky vendim është marrë në mënyrë unanime nga të tre gjyqtarët. Në fakt e vërteta ishte krejt ndryshe, për shkak se nga avokatja e saj, pasi ajo studioi dosjen përkatëse, u zbulua që vendimi nuk ishte unanim, por ishte me 3 mendime të ndryshme, ishte një vendim i marrë pa shumicë votash. Përvec, vendimit të arsyetuar të gjykatës, në dosjen gjyqësore rezultojnë edhe "Mendim Paralel" i gjyqtarit {...} dhe "Proces-verbal" përmbledhës i motiveve kundërshtuese i Gjyqtarit {...}. Të tre këto akte përmbanin arsyetime të ndryshme, të cilat janë bërë prezent në përmbajtjen e recursit.

49. Vendimi nr. {...}, datë {...} i Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është një vendim absolutisht i pavlefshëm si vendim i marrë në kundërshtim me parashikimet e neneve 381 dhe 383/2 të Kodit të Procedurës Penale.Kështu vendimi i arsyetuar nr. {...},dt. {...} i Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që i është njoftuar të përfaqësuarës prej meje, megjithëse mban shënimin "d.v" nën emrin e secilit prej tre gjyqtarëve të trupit gjykues, është një vendim i cili në fakt reflekton vetëm vendimmarrjen e gjyqtares {...}. Gjyqtari {...} rezulton të ketë nënshkruar dhe depozituar bashkëlidhur vendimit aktin "Mendim Paralel" (9 fletë), ndërsa gjyqtari {...} ka depozituar

aktin "Proces-verbal përmbledhës i motiveve kundërshtuese" (6 fletë). Kjo vendimmarrje e Gjykatës së Posaçme të Apelit vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 381 të Kodit të Procedurës Penale, pasi bën që në fakt për çështjen penale në ngarkim të të përfaqësuarës prej meje të mos ketë një vendimmarrje shumice të gjykatës së apelit.

50. Në datë 12.02.2024, e përfaqësuar prej meje është njoftuar nëpërmjet postës me shkresën nr.385/3 prot. dt. 07.02.2024, shkresë e cila ka patur të bashkëngjitur vendimin përkatës nr.385/1 dt.07.02.2024 "për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë" ndaj saj.

51. Menjëherë sapo u njoh me vendimin e ILD-së nr.385/1 dt.07.02.2024, konform nenit 123/dh të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, e përfaqësuar prej meje vendos që të ushtrojë të drejtën e saj të përcaktuar në këtë dispozitë, për të bërë parashtrime dhe kërtime në lidhje me hetimin disiplinor, të filluar nga ky organ si dhe për të dorëzuar dokumente mbështetëse, brenda tre javëve nga momenti i marrjes dijeni për atë vendim, por jo vetëm edhe i ka kërkuar që të pezullohet hetimi disiplinor ndaj saj.

52. Sa parashtrua më sipër, vazhdojmë ti qëndrojmë mendimit juridik, e për pasojë të ripërsërisim përpara jush kërkesën për pezullimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates {...} të nisur nga ILD deri në përfundim të gjykimit të çështjes penale në Gjykatë të Lartë, dhe të vazhdojë të gëzojë statusin "e pezulluar" me vendim të KLGJ

53. Rezulton së çështja penale e ngritur ndaj të përfaqësuarës prej meje, vazhdon të ndjekë rrugën gjyqësore, pasi e përfaqësuar prej meje është në pritje të shqyrtimit të çështjes në Gjykatë të Lartë, çka do të thotë se është vetëm gjykata, ajo që do të vërtetojë përfundimisht ekzistencën ose jo të këtij fakti penal të pretenduar, se do të jetë ajo gjykatë që do të deklarojë ligjshmërinë ose jo të vendimarrjes absurde të Gjykatës së Posaçme të Apelit. Në këtë rast vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë është vendim i formës së prerë në kuptimin e një vendimi final, me fuqinë e gjësë së gjykuar "*res judicata*".

54. Bazuar në arsyetimin e Vendimit Unifikues nr.2 datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arsyetim i cili ka unifikuar praktikën gjyqësore në lidhje me uniformitetin e nocionit "vendim i formës së prerë", Ju parashtror, por ndërkohë edhe Ju kërkoj që vendimi nr.385/1 dt.07.02.2024 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "për fillimin e procedimit disiplinor" ndaj të përfaqësuarës prej meje, duhet të pezullohet, bazuar në nenet 123, 126 dhe 145 të ligjit nr 96/2016 "Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.

55. Nisja e këtij procedimi disiplinor është në kundërshtim me nenin 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i cili citon që vendimi i dënimit duhet të jetë i formës së prerë, dhe vjen në kundërshtim me ligjin nr 96/2016 "Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" neni 104 sipas të cilit vendimi i dënimit duhet të jetë i formës së prerë. Po ashtu vjen në kundërshtim me vendimin unifikues nr.2 dt.03.11.2014 të Gjykatës së Lartë, i cili ka përcaktuar si vendim të formës së prerë, vendimin e Gjykatës së Lartë, kur çështja ndiqet me rekurs, ashtu sikurse ka vepruar e përfaqësuar prej meje menjëherë sapo

është njohur me vendimin e Gjykatës së Posaçme të Apelit. Ky procedim disiplinor vjen në kundërshtim me nenet 30 dhe 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilët citohet se: Neni 130 : "Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë". Neni 135: "Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj".

56. Nën dritën e vendimit unifikues nr.2/2014 të Gjykatës së Lartë, rezulton i qartë sqarimi i nocionit të "vendimit penal të formës së prerë". Ky Vendim Unifikues ka saktësuar sentencën juridike se do të konsiderohet vendim i formës së prerë ai vendim që vjen si pasojë e rekursit të ushtruar në Gjykatën e Lartë, brenda afateve ligjore, si një mjet i zakonshëm ankimi. Në rastin konkret, e përfaqësuar prej meje e ka ushtruar rekursin në Gjykatë të Lartë brenda afatit ligjor, ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, çka do të thotë se nga ky këndvështrim, vendimi penal nuk ka marrë ende formë të prerë. Në këto rrethana, çmoj që vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit dt.26.01.2024 i dhënë ndaj të përfaqësuarës prej meje, nuk mund të konsiderohet përfundimtar dhe detyrues, pasi ai është i hapur për shqyrtim, dhe është objekt kontrolli nga një gjykatë më e lartë.

57. Vlen të citojmë me forcë faktin që vetë Vendimi Unifikues nr.2/2014 ka ardhur në sentencën unifikuese që me shprehjen "formë e prerë" do të kuptojmë "vendimin e ekzekutueshëm" të gjykatave të apelit. Kjo do të thotë se në këtë rast nocioni i "formës së prerë" pikërisht pas përfundimit të gjykimit në apel, shërben thjesht dhe vetëm për efekt ekzekutueshmërie të vendimit, dhe jo për ta konsideruar atë shterues në kuptimin e ekzistencës, apo ligjshmërisë së faktit penal, apo akoma më tepër nuk jep asnjë kuptim tjetër në sensin e shterimit të pasojave që vijnë nga një vendim penal i formës së prerë.

58. Në nenin 126 të ligjit nr 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përcaktohet se: "*Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos: "Pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal në të cilin palë është magjistrati; Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë"*".

59. Sa sipër, paraprakisht nga e përfaqësuar prej meje i është kërkuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që të vendosë "*pezullimin e hetimit disiplinor ndaj saj deri në dhënien e vendimit final, të formës së prerë nga Gjykata e Lartë*", kërkesë për të cilën nuk ka marrë asnjë përgjigje, prandaj dhe jemi të detyruar që ta ripërsërisim atë përpara jush.

60. Nisur nga sa sipër, rezulton se vendimi nr.385/1 prot. dt. 07.02.2024, "Për fillimin e hetimit disiplinor" ndaj të përfaqësuarës prej meje, magjistrate {...} është në kundërshtim me ligjin nr 96/2016 "Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pasi vendimi i dënimit cituar më lart i dhënë nga Gjykata e Posaçme e Apelit, nuk ka marrë formë të prerë, po të mbani parasysht shkeljet flagrante të bëra në vendimarrjet e sipërme, e që do të shqyrtohen nga Gjykata e Lartë.

61. Përfundimisht kërkojmë nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 126 dhe 145 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, të vendosë : "*Pezullimin e procedimit disiplinor të nisur nga I.L.D.*

deri në përfundim të gjykimit në ngarkim të të përfaqësuarës prej meje me vendim gjyqësor të formës së prerë nga Gjykata e Lartë”. Po ashtu ju kërkojmë mbajtjen e statusit” e pezulluar” sipas vendimit nr.346 dt.27.07.2022 të K.L.GJ.

62. Bashkëngjitur me këtë parashtresë, do të gjeni këto akte shkresore :

- Vendimin Unifikues të Gjykates së Lartë nr.2/2014.
- Vendimin penal nr.45 dt.04.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. (Vendimi i gjyqtarëve me shumicë votash).
- Vendimin penal nr.45 dt.04.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. (Vendimi i gjyqtarës në pakicë).
- Vendimin nr.2 dt.26.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit, gjyqtare {...}.
- Aktin “Mendim Paralel” të gjyqtarit {...} (9 fletë),
- Aktin “Proces-verbal përmbledhës i motiveve kundërshtuese” të gjyqtarit {...} (6 fletë).
- Rekursi dt.14.05.2024 drejtuar Gjykatës së Lartë.

## **V. Ligji i Zbatueshëm:**

### **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

63. Neni 137 parashikon se: “Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi.”

64. Në nenin 147, pika 1 sanksionohet se: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë....”

65. Neni 147/d përcakton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

66. Neni 140 i Kushtetutës parashikon se: “1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. 2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. ...”

### **Ligji “Për Statusin”**

67. Neni 138 i ligjit përcakton momentin e fillimit të procedimit disiplinor. Në këtë dispozitë të titulluar “*Fillimi i procedurës disiplinore*”, parashikohet shprehimisht se: “1. Përveç parashikimeve të nenit 152, të këtij ligji, nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.”<sup>9</sup>

68. Neni 146, pika 2 e ligjit parashikon se: “2. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli: a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore. 3. Këshilli nuk është i detyruar t’i qëndrojë masës disiplinore të propozuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim të paktën brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.”

69. Neni 104 i ligjit vendos shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale. Kjo dispozitë ligjore është shfuqizuar me vendimin nr.34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese. Në vijim, ky nen është plotësuar me ligjin nr.48/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”<sup>10</sup>, dhe aktualisht, në këtë nen parashikohet se: “1. *Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale dhe që, sipas natyrës së tyre, diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuar nga gjykata.* 2. *Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë edhe veprime, mosveprime ose sjelljet, sipas pikës 1, të këtij neni, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, ose magjistrati është rehabilituar, ose ka përfituar nga falja apo amnistia.* 3. *Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për aq sa është e nevojshme.”*

70. Neni 111 parashikon masën e shkarkimit të magjistratit nga detyra. Sipas kësaj dispozite sanksionohet se shkarkimi jepet si masë disiplinore vetëm në këto raste: a) kur shkelja është shumë e rëndë; b) kur Këshilli çmon se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin e tij, për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi, për shkak të paaftësisë së rëndë dhe të dukshme, ose për shkak të një sjelljeje që kryhet të paktën me pakujdesi të rëndë, sipas nenit 101, shkronja “b”, të këtij ligji, dhe që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor.

<sup>9</sup> Neni 138, ndryshuar me ligjin Nr. 15/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr.140, datë 30 Korrik 2020.

<sup>10</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr.116, datë 6 Gusht 2019.

71. Neni 172, pika 3 dhe 4 e ligjit parashikon dispozita kalimtare për procedimet disiplinore, sipas të cilës për shkeljet disiplinore të parashikuara sipas këtij ligji, që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të tij, dhe që parashikoheshin si të tilla në kohën e kryerjes së tyre, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji, duke garantuar parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm për magjistratin që ka kryer shkeljen disiplinore.

## **Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë**

72. Neni 319/ç i Kodit sanksionon veprën penale të “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”<sup>11</sup>, sipas të cilit: *“Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e funksionin e tij, dënohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.”*

72.1. Ndërsa neni 25 i K.Penal sanksionon kuptimin e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale, sipas të cilit: *“Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre”*

## **Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë**

73. Neni 462, pika 3, germa b) përcakton vendimet e ekzekutueshme – *“...3. Janë vendime të formës së prerë: ...b) vendimi i gjykatës së apelit kur zgjidh përfundimisht çështjen, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 428, të këtij Kodi; c) vendimi i Gjykatës së Lartë në rastet e ekstradimit dhe transferimit të personave të dënuar.”*

74. Në vijim, neni 428, pika 1, shkronja a), b) dhe c) parashikohet vendimi i gjykatës së apelit: *“1. Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos: a) lënien në fuqi të vendimit; b) ndryshimin e vendimit; c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit; ...”*

## **VI. Vlerësimet dhe Konkluzionet e Këshillit:**

75. Këshilli pasi administroi provat e depozituara në kuadër të shqyrtimit të këtij procedimi disiplinor, në seancën dëgjimore të datës 29.05.2024 vijoi me marrjen në shqyrtim të kërkesës paraprake/procedurale, me objekt *“Pezullimin e procedimit disiplinor të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë sipas vendimit nr.385/1 prot., datë 07.02.2024 për fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjstrates {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, deri në përfundim të gjyqimit në Gjykatën e Lartë të procesit penal”*

<sup>11</sup>Shtuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004; numërtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013

75.1. Duke qenë se jemi në kushtet kur vendimi nr.02, datë 26.01.2024, i Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me të cilin është dënuar gjyqtare {...}, për kryerjen e krimit të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, konsiderohet vendim i formës së prerë referuar parashikimeve të nenit 462, pika 3, shkronja "b", të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 428, pika 1, shkronjat "a" dhe "b" të Kodit të Procedurës Penale, Këshilli vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullimin e procedimit disiplinor.

76. Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Gjykata Kushtetuese<sup>12</sup> ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës, kërkon në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat ndërsa japin drejtësi, t'u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve<sup>13</sup>. Bazuar në parashikimet kushtetuese pushteti gjyqësor, përveç pavarësisë së jashtme (*pavarësia nga pushtetet e tjera*), ka edhe një pavarësi të brendshme (*gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve*)<sup>14</sup>.

77. Nga ana tjetër, në nenin 147, pika 1 të Kushtetutës, parashikohet si organ kushtetues Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili siguron jo vetëm pavarësinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, por dhe përgjegjshmërinë e tij. Në kuadër të kësaj fryme, Kushtetuta ka parashikuar se gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, por, ai nuk përjashtohet nga përgjegjësia në rastet e dhënies qëllimisht të një vendimi gjyqësor, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi.

78. Përveç organeve të reja të qeverisjes së sistemit gjyqësor, ndryshimet e fundit kushtetuese parashikojnë dhe krijimin e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë, si organi kushtetues përgjegjës, për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve, si dhe për inspektimin e gjykatave të të gjitha niveleve, brenda kufijve të të drejtave dhe procedurës së parashikuar në ligj.

79. Dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore përcaktojnë në mënyrë të ndarë fazat e procesit disiplinor ndaj gjyqtarëve, të cilat janë hetimi disiplinor, i cili realizohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe procedimi disiplinor, i cili do të shqyrtohet dhe vendoset vetëm nga Këshilli, si një organ vendim-marrës kolegjial.

80. Neni 140 i Kushtetutës parashikon se gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. Në këtë zbatim të këtij parashikimi kushtetues është miratuar Ligji për Statusin, i cili normon parimet e procedimit disiplinor, llojet e shkeljeve dhe të masave disiplinore që mund të caktohen ndaj magjistratit, si dhe procedurat hetimore dhe disiplinore që ndiqen ndaj tij nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli.

---

<sup>12</sup> Shih vendimin nr. 5, datë 16.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>13</sup> Neni 145, pika 1 e Kushtetutës – “1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve...”

<sup>14</sup> Shih vendimin nr. 40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese.



81. Bazuar në këto dispozita kushtetuese dhe ligjore, Këshilli vlerëson se një masë disiplinore ndaj një gjyqtari duhet të jepet, gjithnjë dhe vetëm, në kuadër të një procedimi disiplinor, të filluar nga organi kompetent, dhe të shqyrtuar sipas procedurave të parashikuara në Ligjin për Statusin, në funksion të garantimit të një procesi të rregullt ligjor dhe të parimeve të procedimit disiplinor të tilla si: parimi i ligjshmërisë, akuzës, barazisë para ligjit, prezumimit të pafajësisë, proporcionalitetit, etj.

82. Nga provat e administruara, rezulton se me vendimin nr.385/1 prot., datë 07.02.2024 të Inspektorit të Lartë i Drejtësisë, është vendosur fillimi i hetimit disiplinor me iniciativë ndaj gjyqtarës znj. {...}, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja b) si dhe nga neni 104 i Ligjit për Statusin. Në kohën e kësaj vendimmarrje, Këshilli konstaton se kanë qenë në fuqi dispozitat ligjore, të shtuara me ligjin nr.48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

83. Në këtë moment, konstatohet se kishin hyrë në fuqi dispozitat e Ligjit nr.48/2019<sup>15</sup>. Konkretisht, në nenin 104 të këtij ligji përcaktohen shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale. Sipas pikave 1 dhe 3 të këtij neni, sanksionohet se shkelje disiplinore do të konsideroheshin veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, rast në të cilin, jepet vetëm masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra” duke zbatuar, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e Ligjit për Statusin, për aq sa është e nevojshme.

84. Referuar gjendjes së fakteve dhe parashikimeve ligjore në fuqi, si në kohën e kryerjes së shkeljeve ashtu dhe të marrjes së vendimit penal formë të prerë, Këshilli vëren se shkeljet disiplinore të kryera nga magjistratja, znj. {...}, përbëjnë njëkohësisht shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një krimi, për të cilin ai është dënuar me vendim të formës prerë.

85. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në pikën 2 të nenit 140 të saj, e ka lidhur shkarkimin e gjyqtarit me dy kategori shkeljesh:

- shkeljet e rënda profesionale ose etike, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe,
- kryerjen e një krimi, për të cilin gjyqtari është dënuar me vendim të formës së prerë.

85.1 Referuar pikës 1 të këtij neni, vendoset përgjegjësia disiplinore me ligj e gjyqtarit, duke ia lënë ligjvënësit kompetencën e përcaktimit të veprimeve ose mosveprimeve që konsiderohen si shkelje disiplinore, duke e kufizuar këtë autorizim apo delegim vetëm për shkeljet të cilat pasjellin shkarkimin e gjyqtarit nga detyra. Më tej, me miratimin e Ligjit për Statusin u individualizuan shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale, në nenin 104 të tij, shtuar me ligjin nr.48/2019. Në vendimin për shfuqizimin e nenit 104,

---

<sup>15</sup>Botuar në Fletoren Zyrtare nr.116, datë 6 Gusht 2019.

Gjykata Kushtetuese ka argumentuar se ligjvënësi, kishte parashikuar raste të tjera shkarkimi, në mungesë të delegimit të shprehur të nenit 140 të Kushtetutës, duke cënuar kështu nenin 116 të saj.

86. Këshilli vlerëson se ekzistenca e shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji, në tërësi, apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre, duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme<sup>16</sup>, kërkesë e cila lidhet me parimin e sigurisë juridike. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai mund të vendosë edhe kufizime, por këto kufizime duhet të bëhen vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve, me mënyra dhe forma, që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e së drejtës dhe garancitë<sup>17</sup>.

87. Nga analiza në tërësi e përmbajtjes së këtyre normave ligjore, Këshilli vëren se ngritja në nivel kushtetues e shkeljeve që sjellin si pasojë shkarkimin e gjyqtarit nga detyra, konkretisht në nenin 140 të Kushtetutës, është bërë nga ligjvënësi për shkak të rëndësisë që ka për magistratin, nën aspektin e pasojës që sjell kjo shkelje disiplinore. Si e tillë kjo dispozitë plotëson kërkesat për qartësi, qëndrueshmëri, besueshmëri dhe efektivitet dhe gjen zbatim të drejtpërdrejtë, pavarësisht ekzistencës apo ajo të parashikimeve ligjore përkatëse.

88. Shqyrtimi i procedimit disiplinor në Këshill, në këto raste, me anë të zhvillimit të seancës dëgjimore, ka si qëllim verifikimin e ekzistencës së shkeljes, duke respektuar procedurat disiplinore të parashikuar në ligj. Në rast se provohet ekzistenca e kryerjes së një krimi nga ana e gjyqtarit të proceduar, për të cilin ai është dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, nenin 140, pika 2, shkronja b) i Kushtetutës dhe 111 i Ligjit për Statusin, parashikojnë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pa i lënë diskrecion Këshillit, për të vlerësuar dhënien e një mase tjetër disiplinore më të lehtë, në zbatim të parimit të proporcionalitetit.

89. Gjatë seancës dëgjimore rezultoi e provuar se me vendimin nr.45, datë 04.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr.02, datë 26.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjyqtarja znj. {...} është dënuar për kryerjen e veprimeve të kundërligjshme, duke u konsumuar nga ana e saj, elementët e figurës së veprës penale të *“Korrupsionit pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”*, të parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal. Kjo vepër penale, duke u nisur nga formulimi i dispozitës së posaçme dhe për nga natyra e sanksionit penal apo masës së dënimit që parashikohet, kategorizohet nga Kodi Penal si krim<sup>18</sup>.

<sup>16</sup> Shih vendimin nr. 9, datë 26.02.2007; nr. 40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>17</sup> Shih vendimet nr. 40, datë 07.07.2014; nr. 11, datë 06.03.2014; nr. 9, datë 26.02.2007; nr. 11, datë 04.04.2007; nr.36, datë 15.10.2007; nr. 26, datë 02.11.2005; nr. 34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>18</sup>Neni 1 i Kodit Penal - Ligji penal dhe ndarja e veprave penale – *“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre.- Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në*

90. Vendimi gjyqësor i dhënë ndaj gjyqtares, znj. {...}, është një vendim i cili ka marrë formë të prerë, në kuptim të përcaktimeve të nenit 462, pika 3, shkronja b) dhe nenit 428, pika 1, shkronja “a” dhe “b” të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi nr.45, datë 04.07.2023 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është lënë në fuqi me vendimin nr.02, datë 26.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lidhur me llojin e veprës penale të kryer dhe masën e dënimit.

72. Në rastin kur shkelja disiplinore identifikohet me kryerjen e një krimi, për të cilin magjistrati është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ajo konsiderohet aq e rëndë sa e bën magjistratin të papërshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar ushtrimin e funksionit të tij, në një masë të tillë, ku aplikimi i çdo mase tjetër më të lehtë, është konsideruar nga vetë Kushtetuta dhe ligji se nuk mund të ketë rol edukues. Në këtë rast, masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra” të magjistratit, mbron interesin publik, duke e larguar atë nga detyra dhe duke u kthyer për magjistratin, në një masë me natyrë përjashtuese nga sistemi gjyqësor, me karakter të përhershëm.

91. Sa më lart, Këshilli arrin në përfundimin se, në zbatim të parimit të ligjshmërisë dhe të parimit të mosdënimit pa ligj, gjatë këtij procedimi disiplinor rezultoi e provuar se magjistratja, z. {...} është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, dhe si rrjedhojë ndaj saj duhet të vendoset masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra”, e parashikuar në nenin 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës, si dhe neni 111 i Ligjit për Statusin.

92. Në nenin 157 të Ligjit për Statusin parashikohet shprehimisht se: “1. Magjistrati përfiton pagë të plotë gjatë pezullimit, përveç kur parashikohet ndryshe nga përcaktimet e pikave të mëposhtme të këtij neni. 2. Nëse magjistrati dënohet për kryerjen e një veprë penale nga gjykata e shkallës së parë ose jepet masë disiplinore për një shkelje disiplinore nga Këshilli kompetent, Këshilli mund të pezullojë përfitimin e pagës deri në 50 përqind, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, derisa të vendoset mbi çdo ankim të paraqitur në gjykatën më të lartë. 4. Nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në disfavor të magjistratit, shumat e mbajtura, sipas pikës 2, të këtij neni, vazhdojnë të mbahen derisa çështja penale ose disiplinore, për të cilën është vendosur pezullimi i përfitimit, të përfundojë me vendim të formës së prerë.”

93. Sipas këtij parashikimi ligjor sanksionohet rregull i përgjithshëm se magjistrati në rastet e pezullimit të tij nga detyra vijon të përfitojë të plotë pagën si dhe përfitimet e tjera që rrjedhin nga ushtrimi i detyrës së tij, përveç një vendimi të kundërt nga ana e Këshillit. Në

---

*çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi.” Neni 32 i Kodit Penal - Dënimi me burgim – “Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet. Për kundërvajtje penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet.”*

vijim, pika 2 e nenit, përcakton rastet në të cilat, Këshilli mund të pezullojë këto përfitime deri në 50 përqind të masës së tyre, të cilat lidhen me dy rrethana fakti:

- ✓ dënohet për kryerjen e një veprë penale nga gjykata e shkallës së parë ose
- ✓ jepet masë disiplinore për një shkelje disiplinore nga Këshilli kompetent.

Kjo masë pezullimi qëndron në fuqi derisa të vendoset mbi çdo ankim të paraqitur në gjykatën më të lartë dhe derisa çështja penale ose disiplinore, për të cilën është disponuar me vendim në disfavor të magjistratit të përfundojë me vendim të formës së prerë.

94. Në rastin konkret, siç dhe u parashtrua më lart, në kohën e shqyrtimit të procedimit disiplinor, Këshilli konstaton se me vendimin nr.45, datë 04.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr.02, datë 26.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, magjistratja znj. {...} është deklaruar fajtores për kryerjen e veprës penale të “Korrupsionit pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, vendim i cili, në kuptim të përcaktimeve të nenit 462, pika 3, shkronja b) dhe nenit 428, pika 1, shkronja a) dhe b) të Kodit të Procedurës Penale, është një vendim penal i formës së prerë.

95. Në referencë të rrethanave të faktit dhe të ligjit, si më lart cituar, Këshilli duke patur në konsideratë vendimarrjet e tij të mëparshme<sup>19</sup>, vlerëson se në kushtet kur magjistratja z. {...} është dënuar për kryerjen e një krimi, nuk ndodhet para rastit të pezullimit të pagës dhe të përfitimeve të tjera deri në 50 përqind, për shkak se çështja penale tashmë ka përfunduar me një vendim të formës së prerë. Si rrjedhojë, trajtimi financiar në përfitimin e plotë të pagës dhe të përfitimeve të tjera ndaj saj duhet të ndërpritet me dhënien e vendimit për caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, jo për shkak të dhënies së kësaj mase disiplinore, por për shkak se magjistrati rezulton i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

96. Në lidhje me të drejtën e ankimit, Këshilli vëren se neni 147 i Ligjit për Statusin përcakton të drejtën e ankimit ndaj vendimeve disiplinore. Sipas këtij neni, magjistrati dhe Inspektori kanë të drejtë të ankimojnë vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente. Ndërkohë, neni 140 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht se: “...4. Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.” Një dispozitë e veçantë për ankimet është vendosur dhe në Ligjin nr.115/2016, “Për Organet e Qeverisjes Vendore së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, konkretisht në nenin 100, në të cilin parashikohet se: “1. Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Aktet

---

<sup>19</sup> Vendimi nr. 223, dt 02.06.2021 “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Kliton Spahiu” dhe Vendimi nr. 462, datë 11.10.2021 “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Roland Hysi”  
Vendimi nr. 180, datë 09.04.2024 “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistrates Mimoza Margjeka”

*administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi gjyqtarët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese... .”*

97. Në vijim të procesit të ankimit, neni 179, pika 7 e Kushtetutës parashikon shprehimisht se “....7. Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë... .”

98. Bazuar në këto dispozita ligjore, Këshilli konstaton se subjektet e këtij procedimi disiplinor kanë të drejtë të ushtrojnë ankim ndaj këtij vendimi tek gjykata kompetente, që do të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të tij për marrjen e masave disiplinore ndaj magjistratëve, që është Kolegji i Posaçëm i Apelit.

99. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1, nenin 147/a, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 146, pika 2, shkronja “b” dhe nenin 157, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 86, shkronja “e” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

## **V E N D O S I:**

1. Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Shkarkimin nga detyra të magjstrates znj. {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
3. Ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, të pagës si dhe të përfitimeve të tjera të magjstrates znj. {...}.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, afat i cili fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
5. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’u njoftohet subjekteve të procedimit disiplinor, magjstrates znj. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**